

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarve XH.H., nga Lipjani, B.L., nga fshati ..., Komuna e Podujevës dhe S.L., nga Prishtina, për shkak të veprës penale në vazhdimësi Vjedhje e rëndë, nga neni 253 par. 1 nën par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokuroria Themelore në Ferizaj, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.212/13, datë 09.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 25.02.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.212/13, datë 09.11.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin P.nr.212/13, datë 09.11.2018, të akuzuarin XH.H., e ka shpallur për shkak të veprës penale në vazhdim Vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 nën par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim duhet të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil. Është obliguar i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € në afatin prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm si dhe është obliguar që të paguaj shumën prej 30 € në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në bazë të nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KPPK-së, të akuzuarit B.L. dhe S.L., janë liruar nga akuza, për shkak se nuk është provuar se të njëjtit në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi kanë kryer veprën penale e cila iu është vënë në barrë me anë të aktakuzës. Shpenzimet e procedurës kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Në kuptim të nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së, për të akuzuarin B.L. është refuzuar akuza për veprën penale në vazhdim Vjedhje e rëndë, nga neni 253 par. 1 nën par. 1 lidhur me nenin 13 të KPK-së, për shkak se prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor është tërhequr nga akuza. Shpenzimet e procedurës kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë për pjesën lirueses ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta anuloj vetëm sa i përket pikës II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar dhe çështjen penale ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.106/2019 datë 01.02.2019, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të shtetit, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të anulohet vetëm sa i përket pikës II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar dhe çështja penale ta kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa e prokurorit të shtetit, nuk është e bazuar

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të ligjit penal.

Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, prokurori i shtetit në ankesën e tij pretendon se, gjykata e shkallës së parë në këtë çështje penalo juridike lidhur me pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka liruar nga akuza të akuzuarit B.dhe S.L., meqë nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale e cila iu është vënë në barrë me anë të aktit akuzues. Duke marrë parasysh se një vlerësim i tillë i provave të administruara në seancën kryesore është i gabuar sepse gjykata e shkallës së parë ka anashkaluar faktin se edhe në procedurën hetimore i akuzuari B. kishte pranuar se kishte vjedhur stoli ari, një llap top dhe një televizor, mirëpo gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka mohuar të njëjtën se gjoja nuk ka ditur se çka nënshkruar para policisë, e po ashtu edhe i akuzuari S. gjatë procesverbalit të marrjes në pyetje në polici kishte pranuar se kishte vjedhur disa llap topa së bashku me vëllain e tij B. si dhe XH.H. edhe pse koha nuk i kujtohet, po ashtu ka deklaruar se arin që kishin vjedhur në Ferizaj e kishin shitur në argjendarinë në Prishtinë, mirëpo gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë mohuar veprat penale edhe pse nga ana e të

dëmtuarit është vërtetuar fakti se të akuzuarit kanë kryer veprat penale. Sipas prokurorit të shtetit, gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejtë gjendjen faktike duke pasur parasysh edhe deklaratën e të akuzuarit XH.H., i cili pasi që kishte pranuar fajësinë për këto vepra penale i njëjti kishte deklaruar se këto vepra i kishte kryer së bashku me B. dhe S.. Gjykata e shkallës së parë gabimisht nuk ka marrë për bazë deklaratat e dëshmitarëve I.S., B.S., N.H., dhe F.M., ngase prokuroria e shtetit ka paraqitur prova të mjaftueshme në shqyrtimin gjyqësor që vërtetojnë se është kryer kjo vepër penale në aspektin objektiv dhe atë subjektiv. Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vlerësuar faktin se në veprimet në të cilat akuzohen të akuzuarit nuk përbëjnë figurën e veprës penale e këtu marrim parasysh përmbajtjen e shkresave, procesverbaleve mbi deklaratimet dhe provave tjera të cilat i janë ofruar gjykatës së shkallës së parë për ta provuar bazën e akuzës së tyre. Për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, krahas arsyeve të përmendura aktgjykimin në fjalë e bënë të paqëndrueshëm edhe fakti se i njëjti është pasoj e një vërtetimi jo të drejtë dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Andaj, duke i marrë parasysh të gjitha këto rrethana sipas prokurorit të shtetit faktet të cilat janë administruar gjatë seancës kryesore, e që janë relevante për themelimin e drejtë të vendimit. Gjykata e shkallës së parë po ti merrte parasysh të njëjtat nuk do ta themelonte vendimin e vet duke anashkaluar këto fakte në mënyrë të gabuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mësipërme të Prokurorit nuk qëndrojnë nga se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, prandaj pa të drejtë ankimohet aktgjykimin në këtë pjesë sepse, gjykata e shkallës së parë drejtë i ka vlerësuar provat e administruara të propozuara në aktin akuzues dhe ato në shqyrtimin gjyqësor dhe në bazë të provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara drejtë dhe plotësisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka gjetur se të akuzuarit B.L. dhe S.L., nuk është argumentuar se, kanë kryer veprën penale në vazhdimësi dhe bashkëkryerjeVjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 nën par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës sikurse në pikën II të aktgjykimin të ankimuar, kështu që në mungesë të provave të akuzuarit me të drejtë i ka liruar nga akuza. Andaj gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje penale në cilësi të dëshmitarëve ka dëgjuar të dëmtuarit I.S., B.S., N.H., F.M. dhe S.M., mbrojtjen e të akuzuarve XH.H., S.L. dhe B.L., deklaratat e të akuzuarve të dhëna në polici si dhe nga shikimi i shkresave tjera të lëndës. Nga deklarata e të akuzuarit XH.H., gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar dhe pjesërisht i ka falur besimin se të dy të akuzuarit e lartcekur nuk kanë qenë të pranishëm me rastin e kryerjes së veprave penale nga ana e tij, kësaj pjese të deklaratës gjykata ja fali me të drejtë besimin ngase e kundërta nuk mund të vërtetohej me asnjë provë tjetër të cilat gjinden në shkresat e lëndës. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe deklaratat e dëshmitarëve-të dëmtuarve në polici, por nga të njëjtat gjykata ka gjetur se të njëjtat përveç që provonin se veprat penale kishin ndodhur por me asnjërin prej tyre nuk mund të dëshmohej në mënyrë bindëse dhe të pa kontestueshme se të akuzuarit B.L. dhe S.L. e kishin kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, ngase asnjëri nga të dëmtuarit nuk i kanë parë të akuzuarit në vend ngjarje dhe nuk mund t'i identifikonin të njëjtit si kryes të këtyre veprave penale. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar dhe

administruar të gjitha provat në këtë çështje penale e në lidhshmëri me njëra tjetrën drejtë ka konstatuar se të akuzuarit nuk e kanë kryer veprë penale sikurse që i është vënë në barrë me anë të aktit akuzues. Një vlerësim të tillë si drejtë dhe të ligjshëm, e vlerëson edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në rastin konkret se të akuzuarit nuk janë përgjegjës për veprën penale për të cilën akuzohen, se nga faktet e ofruara nga prokurori i shtetit dhe dëshmitarët e propozuar nga ana e prokurorit janë kontradiktorë dhe nuk përputhen me gjendjen faktike. Po ashtu gjykata në rastin konkret drejt ka aplikuar nenin 3 par. 2 të KPPK-së ku thuhet “se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të Ligjit Penal interpretohen në favor të akuzuarit dhe të drejtave të tij”.

Për pjesën dënuese dhe refuzuese aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ngel i paprekur.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitave të nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr. 42/19, datë 25.02.2019

Zyrtari ligjor
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Biljana Rexhiq